



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS ISHËM - ERZEN

VENDIM

Nr. 12 datë 7.03.2014

Për

Shfuqizimin e vendimit Nr.2, datë 19.6.2009 të K.B.U-së, leje përdorimi të rezervës ujore inbotilim, subjekti “Fajger” sh.p.k, Mali me Gropa, Tiranë.

Në mbështetje, të nenit 55 pika ç “Revokimi e shfuqizimi i autorizimeve dhe lejeve dhe zgjidhja e kontratës konçensionare”, të Ligjit 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Ujrave”, të shkresës nga Drejtoria e Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, Nr. 30404/1 datë 27.04.2012 “Kthim përgjigje” për Prefekturën e Qarkut (Sektori i Kompetencave Vendore), subjekti “Fajger” Sh.p.k nuk është i regjistruar pranë Drejtorisë Tatimore.

Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishëm – Erzen:

VENDOSI

1. Shfuqizimin e vendimit Nr.2 datë 19.6.2009 të K.B.U-së për përdorim të rezervës ujore inbotilim subjektit “Fajger” sh.p.k, Mali me Gropa, Tiranë.
2. Ngarkohet A.U.B Ishëm – Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

PËR GJEGJËSI A.U.B
ISHËM – ERZEN
Shpëtim MEDIU



KRYETARI I K.B.U
ISHËM - ERZEN

Sadi VORPSI

